

Vendim nr. 201 datë 22.07.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Sandër Beci,	Anëtar
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 22.07.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 15 (Sh) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUESI: **SHOQËRIA “ARSI-GROUP” SH.P.K.**

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 5781, datë 17.10.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; nr. 2081, datë 16.05.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2024-4696, datë 26.11.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 11, 17, 41, 42, 49, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, si dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të saj; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në datën 12.04.2001 mes Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit e shoqërisë aksionere italiane “Darfo” s.p.a. është lidhur marrëveshja koncesionare e formës “ROT” për dhënien me koncesion të Minierës së Kromit Bulqizë, Fabrikës së Pasurimit, Bulqizë, Impiantit të Seleksionimit Klos dhe Uzinës së Ferrokromit, Burrel. Kjo marrëveshje është lidhur për një periudhë 30-vjeçare, me investim të fazës së parë 2.7 milionë dollarë, për t’u realizuar për një periudhë prej 3 vjetësh dhe me investim të fazës së dytë prej 7.3 milionë dollarësh, të realizueshëm për 5 vjetët në vijim. Sipas nenit 6, shkronja “d”, të marrëveshjes, ministria merrte përsipër, ndër të tjera, të asistonte koncesionarin për realizimin e projektit pranë çdo organi e autoriteti shqiptar e t’i garantonte atij dhe shoqërisë koncesionare ekskluzivitetin për realizimin e projektit për objektet e dhëna në koncesion gjatë periudhës së koncesionit. Kjo marrëveshje është miratuar me ligjin nr. 8791, datë 10.05.2001 dhe, mbi bazën e saj, subjektit “Darfo Albania” sh.p.k. i është dhënë leja e shfrytëzimit nr. 677, datë 16.09.2002 (leja nr. 677/2002) për sipërfaqen e tokës 0.92 km², me vendndodhje afër Bulqizës, sipas hartës topografike bashkëlidhur lejes dhe koordinatave kufizuese. Në datën 11.12.2007 shoqëria “Darfo Albania” sh.p.k. ka ndryshuar emrin e saj në “Albania Chrome” sh.p.k. dhe, më pas, në datën 21.03.2013 në “Albchrome” sh.p.k.

2. Po kështu, në datën 13.08.2010 shoqëria “Arsi” sh.p.k., sot shoqëria “Arsi-Group” sh.p.k. (kërkuesja), është pajisur nga Qendra Kombëtare e Licencimit me lejen nr. PN-0699-08-2010 për shfrytëzimin e mineralit krom, sipas kufizimeve dhe detyrimeve të legjislacionit në fuqi, me vlefshmëri deri në datën 13.08.2030. Kjo leje është miratuar me aktin nr. 1486, datë 28.07.2010 të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE) “Për leje minerare shfrytëzimi” (leja nr. 1486/2010), të dhënë për sipërfaqen e tokës 0,0069 km² të vendosur në brendësi të masivit ultrabazik të Bulqizës, rreth 2 km larg qendrës së qytetit, duke iu kërkuar të kryejë programin e zhvillimit dhe të investimeve, sipas parametrave: rezerva gjeologjike 6.000 tonë; rezerva të nxjerrshme 2.400 tonë; të prodhojë ton/vit; totali i investimeve 184.300 dollarë. Në zbatim të kërkesave ligjore për shfrytëzimin e objektit të lejes minerare, kërkuesja ka raportuar kushtet financiare dhe teknike tek autoritetet mbikëqyrëse.

3. Në datën 15.08.2013 shoqëria “Albchrome” sh.p.k. i është drejtuar ministrit të METE-s, Kryeministrit dhe Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN) për fshirjen e mbivendosjeve të lejeve të tjera minerare, përfshirë edhe të lejes nr. 1486/2010, me

koordinatat e lejes nr. 677/2002 të dhënë asaj, si dhe revokimin e menjëhershëm të tyre, si për shkak të mbivendosjes, ashtu edhe për shkak të rrezikshmërisë së lartë që ato paraqisnin për minierën dhe njerëzit. Po kështu, në datën 12.09.2013 shoqëria “Albchrome” sh.p.k. i është drejtuar AKBN-së dhe Repartit të Inspektim dhe Shpëtim Minierave (*RISHM*) me ankesë ndaj mosveprimit për pezullimin e aktiviteteve minerare të subjekteve që cenonin aktivitetin e minierës Bulqizë. Sipas ankesës, nga informacioni i datës 12.09.2013, i dhënë nga inxhinieri i kësaj shoqërie për punimet për minierën e Bulqizës, ka rezultuar se subjektet private që shfrytëzonin sterilet në mbivendosje me koordinatat e saj kishin shembur të vetmen rrugë që lidhte pusin A1, duke cenuar rëndë gatishmërinë për ndihmën e shpejtë në rast avarie dhe duke bërë të pamundur që në këtë rrugë të kalonte ambulanca, në rast ndërhyrjeje për ndihmë të shpejtë në të vetmen dalje të minierës, pusi A1. Po kështu, rrezikonin të shembeshin përsëri vaskat e shllamit, ashtu siç ishin shembur 3 javë më parë nga shfrytëzimi i stoqeve prej subjekteve private.

4. Në datën 25.10.2013, me urdhër të ministrit të Energjetikës dhe Industrisë (*MEI*) është ngritur grupi i punës “Për kontrollin e zbatimit të marrëveshjes koncesionare dhe lejeve minerare në rajonin krombajtës Bulqizë”. Sipas gjetjeve të raportit të këtij grupi, mbivendosja e lejes së shfrytëzimit të kërkueses me koordinatat e lejes minerare nr. 677/2002 kishte dëmtuar dhe rrezikuar infrastrukturën përreth. Po sipas raportit, si rrjedhojë e aktivitetit të këtyre shoqërive, në datën 12.09.2013, pas shirave të vullshëm, ishin evidentuar dëmtime të tjera në infrastrukturë, në një sërë banesash dhe në rrugë e në kanalizimet e qytetit të vjetër të Bulqizës. Në këto kushte, leja nr. 1486/2002 dhe lejet minerare që nuk kryenin aktivitet minerar duheshin revokuar. Ky raport i është komunikuar ministrit me shkresën nr. 810/6 prot., datë 16.12.2013.

5. Bazuar në nenin 47, pika 2, shkronjat “b” dhe “c”, të ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 10304/2010*), me urdhrin nr. 159, datë 06.12.2013 (*urdhri nr. 159/2013*) të ministrit të MEI-it është vendosur revokimi i lejes nr. 1486/2010, për shkak të përfundimit të shfrytëzimit të rezervave gjeologjike të llogaritura; detyrimi i kërkueses për marrjen e masave për mbylljen e objektit që ka pasur në shfrytëzim, rehabilitimin e zonës së shfrytëzuar, si dhe dorëzimin e objektit të rehabilituar AKBN-së. Ky urdhër i është njoftuar kërkueses me shkresën nr. 159/1 prot., datë 06.12.2013.

6. Duke mos qenë dakord me urdhrin e ministrit, në datën 23.01.2014 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë me kërkesëpadi për konstatimin si absolutisht të pavlefshëm të tij, duke pretenduar shkeljen nga ministri i MEI-it të procedurave të parashikuara nga ligji nr. 10304/2010 në revokimin e lejes minerare, si dhe nga nenet 44 e vijues të Kodit të Procedurave Administrative (*KPA*), për shkak se: (i) nuk ishte njoftuar për

nisjen e procedurës së revokimit të lejes, nuk kishte marrë pjesë, nuk kishte dhënë mendim për rezervat minerare të zonës e nuk i ishte dhënë mundësia e paraqitjes së provave në procedimin administrativ; (ii) urdhri i ministrit ishte nxjerrë në kapërcim të kompetencave të tij ligjore; (iii) argumenti i ministrit për përfundimin e shfrytëzimit të rezervave ishte i pavërtetë, pasi referuar raportit teknik privat të paraqitur prej saj, rezervat e kromit në zonën e lejes ishin mbi rezervën gjeologjike të llogaritur dhe kjo e fundit nuk ishte prekur e as nuk ishte shteruar; (iv) urdhri nuk ishte bazuar në mendimin e një eksperti.

7. Shoqëria “Albchrome” sh.p.k. ka kërkuar të marrë pjesë si ndërhyrës dytësor në gjykimin e çështjes, kërkesë e cila është pranuar nga gjykata bazuar në nenin 191 të Kodit të Procedurës Civile (KPC). Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, me vendimin nr. 5781, datë 17.10.2014, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, si të pabazuar në ligj e në prova, duke arsyetuar se: (i) pretendimet e kërkuësës për pavlefshmërinë absolute të aktit ishin të pabazuara, pasi neni 48, pika 5, i ligjit nr. 10304/2010 parashikonte shprehimisht se autoriteti për revokimin e lejes minerare i përkiste ministrit, në bazë të raportit të strukturës përgjegjëse; (ii) paligjshmëria potenciale e shkakut të parashikuar në aktin revokues të nxjerrë nuk lidhej me tejkalimin e kompetencave, por me vlerësimin e gabuar të ligjit material, pra nuk përbënte shkak për pavlefshmëri absolute; (iii) edhe pse kërkuësja nuk ishte njoftuar për fillimin e procedurës për revokimin e lejes, sipas nenit 48, pika 3, të ligjit nr. 10304/2010, në gjykim nuk u paraqitën prova të mjaftueshme që mund të bindnin gjykatën se pasojat nuk do të ishin të njëjta nëse procedura do të ishte respektuar; (iv) raporti përfundimtar i realizuar nga specialistët e grupit të punës të MEI-së nuk kishte argumente në opionencë të mjaftueshme për të kundërshtuar konkluzionin e arritur se ushtrimi i aktiviteteve paralele në të njëjtën sipërfaqe toke veprimi, në nivele të ndryshme, kishte dëmtuar dhe paraqiste rrezik për shembjen e rrugëve, kishte dëmtuar veprimtarinë e koncesionarit, si dhe se shfrytëzimi i stoqeve sterile në zonën e mbivendosur ku vepronte koncesionari kishte përfunduar. Kërkuësja ka ushtruar ankim ndaj këtij vendimi.

8. Me vendimin nr. 2081, datë 16.05.2017, me të njëjtin arsyetim, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke e gjetur atë të drejtë e të bazuar në ligj. Kërkuësja ka ushtruar rekurs ndaj vendimit të gjykatës së apelit, për të cilin, me vendimin nr. 00-2024-4696, datë 26.11.2024, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin.

9. Në datën 21.05.2025 kërkuësja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual, i cili, pas plotësimit, sipas parashikimeve të nenit 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 05.06.2025.

II

Pretendimet e kërkuases

10. **Kërkuesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i janë cenuar:

10.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës në drejtim të:

10.1.1. *Së drejtës për t'u dëgjuar*, pasi nuk është njoftuar nga organi administrativ për revokimin e lejes minerare, nuk ka marrë pjesë, nuk i është kërkuar, nuk ka dhënë mendim dhe nuk i është dhënë mundësia të paraqesë prova në procedimin administrativ, fakt ky i pranuar nga gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit, duke iu cenuar në këtë mënyrë edhe e *drejta për mbrojtje ligjore efektive*.

10.1.2. *Së drejtës për gjykim të drejtë*, pasi: (i) gjykatat nuk kanë marrë parasysh pretendimet e saj se (a) urdhri i ministrit për revokimin e lejes minerare është nxjerrë pa marrë më parë mendimin e një eksperti, në shkelje të neneve 84, 86, 87 dhe 89 të KPA-së; (b) në të është parashtruar si shkak përfundimi i shfrytëzimit të rezervave gjeologjike të llogaritura, ndërsa mbivendosja e lejeve të shfrytëzimit nuk është parashtruar ndonjëherë nga ana e ministrisë; (c) sipas akteve të ekspertimit nuk kishte mbivendosje të lejeve. (ii) Në kundërshtim të hapur me ligjin procedural, gjykata e shkallës së parë ka pranuar si ndërhyrës kryesor në gjykim shoqërinë “Albchrome” sh.p.k. edhe pse objekti i padisë nuk kishte të bënte me këtë subjekt, por me institucionin shtetëror që kishte nxjerrë aktin. Gjykata e apelit nuk e ka evidentuar këtë shkelje, edhe pse ishte ngritur nga kërkuësja në ankim. (iii) Gjykatat e faktit nuk kanë marrë parasysh se revokimi i lejes është bërë në kundërshtim me nenet 47 e 48 të ligjit nr. 10304/2010 dhe nenet 44 e vijues të KPA-së, gjetjet e raportit teknik privat për gjendjen dhe lëvizjen e rezervave minerare në zonën në shfrytëzim nga kërkuësja ose aktin e ekspertimit shtesë. (iv) Gjykatat kanë vlerësuar të drejtë urdhrin e ministrit edhe pse nuk ekzistonin prova teknike ose raport gjeologjik që vërtetonin përfundimin e rezervave.

10.1.3. *Parimit të sigurisë juridike*, në drejtim të parashikueshmërisë së ligjit, pasi në mënyrë të njëanshme, retroaktive dhe pa paralajmërim i është hequr një e drejtë e fituar përmes një kontrate afatgjatë, me vlefshmëri deri në vitin 2030.

10.1.4. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykatat kanë ligjëruar shkeljen me arsyetimin se kishte mbivendosje të lejeve të shfrytëzimit, edhe pse kanë pranuar se shkak i përcaktuar në urdhër është ai i përfundimit të rezervës gjeologjike. Gjykata e apelit ka shkuar edhe më tej, duke arsyetuar se pretendimi për pavlefshmërinë absolute të aktit, për shkak të nxjerrjes së tij nga organi në tejkalim të kompetencave ligjore, nuk është provuar, ndonëse në ankim është pretenduar pavlefshmëria, sipas nenit 116 të KPA-së, për shkak të mosrespektimit të procedurës së parashikuar nga ligji. Gjykata e Lartë nuk ka analizuar dhe konstatuar shkeljet ligjore të bëra nga gjykatat më të ulëta.

10.2. *Parimi i barazisë përpara ligjit*, pasi shoqëria “Albchrome” sh.p.k. është pranuar si ndërhyrëse dytësore në proces, pa pasur ndonjë interes të drejtpërdrejtë në çështje, duke ndikuar në mënyrë të padrejtë në rezultatin e gjykimit.

10.3. *E drejta e pronës*, e garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, pasi leja minerare përbën një të drejtë administrativo-ekonomike me natyrë pasurore. Gjykatat kanë legjitimuar cenimin e kësaj të drejte edhe pse qëndrimi i organit shtetëror në urdhrin për revokimin e saj ka qenë i ndryshëm nga ai i mbajtur gjatë gjykimit.

10.4. *Liria e veprimtarisë ekonomike*, pasi heqja e papritur e lejes minerare ka ndikuar në ndërprerjen e veprimtarisë së ligjshme ekonomike të saj, duke e penguar të vazhdojë aktivitetin e saj në përputhje me kontratat dhe pritshmëritë ligjore të garantuara përmes licencës shtetërore.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkueses

11. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr.

8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

12. Kërkuesja, si individ, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

13. Në lidhje me kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive, në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, ajo vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese, që individi pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik. Kriteri për shterimin e mjeteve juridike efektive kërkon që, përpara se t’i drejtohet Gjykatës, kërkuesi duhet të vërtetojë se ka përdorur në formë dhe substancë të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura (shih vendimet nr. 18, datë 19.03.2024; nr. 38, datë 12.07.2023 të Gjykatës Kushtetuese).

14. Në rastin konkret, Kolegji vëren se pretendimet për cenimin e së drejtës së pronës dhe lirisë së veprimtarisë ekonomike, të garantuara nga nenet 41 dhe 11, pika 1, të Kushtetutës, janë parashtruar për herë të parë në ankimin kushtetues individual, pa qenë shteruar më parë mjetet juridike efektive në dispozicion. Ndërsa, pretendimet e tjera janë parashtruar në formë dhe substancë në gjykatat e zakonshme, ndaj në lidhje me to kërkuesja nuk ka më mjete të tjera në dispozicion përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

15. Kërkuesja legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, i cili mban datën 26.11.2024, i është komunikuar kërkueses në adresën e saj elektronike në datën 21.01.2025, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 21.05.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

16. Për sa i takon legjitimitet *ratione materiae*, kërkuesja ka pretenduar se gjykatat e zakonshme i kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për t’u dëgjuar, së drejtës për gjykim të drejtë, parimit të sigurisë juridike e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, si dhe parimin e barazisë përpara ligjit, pretendime të cilat *prima facie* përfshihen në juridiksionin kushtetues.

17. Në kërkesën drejtuar Gjykatës kërkuesja ka pretenduar *cenimin e së drejtës për gjykim të drejtë*, duke parashtruar si shkak se gjykatat kanë pranuar si ndërhyrëse dytësore në gjykim shoqërinë “Albchrome” sh.p.k. edhe pse objekti i padisë nuk kishte të bënte me këtë

subjekt. Po sipas saj, pranimi nga gjykatat i ndërhyrjes në proces të kësaj shoqërie i ka cenuar edhe *parimin e barazisë përpara ligjit*.

18. Për sa i takon këtij pretendimi, Kolegji evidenton se gjykatat e zakonshme kanë pranuar ndërhyrjen në proces të shoqërisë “Albchrome” sh.p.k. në mbështetje të argumenteve të paraqitura nga MEI-ja. Pranimi i ndërhyrjes së kësaj shoqërie është bazuar në parashikimet e nenit 191 të KPC-së, i cili, sipas përmbajtjes së kohës, parashikonte se kushdo mund të ndërhynte në një proces gjyqësor që zhvillohej ndërmjet personave të tjerë, kur kishte interes për të mbështetur njërën ose tjetrën palë, me të cilën bashkohej në gjykim për ta ndihmuar atë. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se interpretimi e zbatimi i ligjit nga gjykatat e zakonshme nuk përshihen në juridiksionin kushtetues për sa kohë që nuk shoqërohen me cenimin e të drejtave kushtetuese (*shih vendimet nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016; nr. 42, datë 07.07.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këndvështrim të kësaj jurisprudence, në rastin konkret, Kolegji çmon se në ankimin kushtetues individual kërkuesja nuk ka arritur të përcaktojë në aspektin kushtetues cenimin e të drejtave të saj kushtetuese, për shkak të ndërhyrjes në gjykim të shoqërisë “Albchrome” sh.p.k. Për rrjedhojë, vlerëson se pretendimet e saj në këtë drejtim nuk mund të merren në shqyrtim.

19. Në kërkesën drejtuar Gjykatës kërkuesja ka pretenduar edhe cenimin e *parimit të sigurisë juridike* në drejtim të *parashikueshmërisë së ligjit*, duke parashtruar si shkak se përmes revokimit të lejes së shfrytëzimit i është hequr një e drejtë e fituar përmes një kontrate afatgjatë, me vlefshmëri deri në vitin 2030.

20. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se parimi i sigurisë juridike kërkon që normat ligjore të jenë të parashikueshme, të qarta, të sakta dhe të kuptueshme. Kur bëhet fjalë për mundësinë e individit për të parashikuar pasojat e veprimeve të tij, nuk është e thënë që të nënkuptohet një qartësi absolute, pasi ligji duhet të jetë në gjendje të ndjekë rrethanat e ndryshme dhe, për këtë arsye, një standard i një parashikueshmërie të arsyeshme është i mjaftueshëm (*shih vendimet nr. 33, datë 20.05.2025; nr. 32, datë 30.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Po sipas Gjykatës, parimi i sigurisë juridike nuk shfaqet asnjëherë si i tillë në vetvete, por shoqërohet me mbrojtjen e të drejtave të fituara, vazhdimësinë ligjore, qartësinë dhe përcaktueshmërinë në normimin e marrëdhënieve juridike dhe respektimin e pritshmërive legjitime (*shih vendimet nr. 25, datë 23.04.2025; nr. 10, datë 29.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Në rastin konkret, Kolegji evidenton se krahas dhënies së lejes minerare (*neni 5*), ligji nr. 10304/2010, sipas përmbajtjes së tij në fuqi në momentin e nxjerrjes së urdhrin të ministrit të MEI-së, parashikonte edhe revokimin e saj, në rastet e përcaktuara në nenin 48 të

tij. Në këndvështrim të parashikimeve të kësaj dispozite (*nenit 48*), në kundërshtim nga sa kërkuesja pretendon, Kolegji vlerëson se përmbajtja e saj nuk rezulton të jetë e paqartë ose e pakuptueshme lidhur me rastet dhe kriteret që justifikojnë revokimin e një lejeje shfrytëzimi minerar. Po kështu, referuar këtyre parashikimeve, dhënia e lejes së shfrytëzimit minerar, pavarësisht vlefshmërisë së saj në kohë, nuk përbën një të drejtë të fituar në kuptim kushtetues, përderisa ligji parashikon qartësisht mundësinë e ndërprerjes së saj në kushte dhe rrethana të përcaktuara shprehimisht. Ndaj, në këtë kuptim, Kolegji çmon se pretendimet e kërkueses për cenimin e parimit të sigurisë juridike në drejtim të parashikueshmërisë së ligjit dhe të drejtave të fituara janë haptazi të pabazuara, ndaj ato nuk mund të merren në shqyrtim.

22. Për sa u përket pretendimeve të tjera për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të *së drejtës për t'u dëgjuar të lidhur me të drejtën për mbrojtje efektive, së drejtës për gjykim të drejtë dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, duke pasur parasysh argumentet në themel të tyre, Kolegji çmon t'i analizojë në vijim së bashku në drejtim të së drejtës për gjykim të drejtë të lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar dhe standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për gjykim të drejtë të lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar dhe standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor

23. Kërkuesja ka pretenduar se nuk është njoftuar nga organi administrativ për revokimin e lejes minerare, nuk ka marrë pjesë, nuk i është kërkuar, nuk ka dhënë mendim dhe nuk i është dhënë mundësia të paraqesë prova në atë proces. Urdhri i ministrit për revokimin e lejes është nxjerrë në shkelje të neneve 47 e 48 të ligjit nr. 10304/2010 dhe neneve 44, 84, 86, 87 dhe 89 të KPA-së. Sipas saj, gjykatat e faktit nuk kanë marrë parasysh pretendimet e saj se urdhri është nxjerrë pa marrë më parë mendimin e një eksperti, raportin teknik privat për gjendjen dhe lëvizjen e rezervave minerare në zonën në shfrytëzim të kërkueses ose aktin e ekspertimit shtesë. Ato kanë ligjëruar shkeljen me arsyetimin se kishte mbivendosje të lejeve të shfrytëzimit, edhe pse kanë pranuar se shkaku i përcaktuar në urdhër ishte ai i përfundimit të rezervës gjeologjike. Gjykata e apelit ka shkuar edhe më tej, duke arsyetuar se pretendimi për pavlefshmërinë absolute të aktit, për shkak të nxjerrjes së tij nga organi në tejkalim të kompetencave ligjore, nuk është provuar, ndonëse në ankim është pretenduar pavlefshmëria, sipas nenit 116 të KPA-së, për shkak të mosrespektimit të procedurës së parashikuar nga ligji. Ndërsa, Gjykata e Lartë nuk ka analizuar dhe konstatuar shkeljet ligjore të bëra nga gjykatat më të ulëta.

24. Neni 42, pika 2, i Kushtetutës, ndër të tjera, parashikon se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues e ligjorë, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se ajo nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme (*shih vendimet nr. 24, datë 23.04.2025; nr. 67, datë 06.12.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Po ashtu, Gjykata ka theksuar se e drejta e individit për proces të rregullt ligjor nuk kufizohet vetëm në procesin gjyqësor, por përfshin edhe atë me karakter administrativ. Sipas Gjykatës, kur ankimi kushtetues individual ka në objektin e tij mënyrën sesi kanë vepruar organet e pushtetit publik, atëherë kontrolli kushtetues ushtrohet për të verifikuar nëse organi administrativ ka përmbushur detyrimet ligjore në atë masë që të jetë respektuar e drejta kushtetuese për proces të rregullt ligjor dhe, në vijim, nëse gjykatat e zakonshme, që kanë shqyrtuar veprimet dhe vendimmarrjen e organit administrativ, kanë vepruar në përputhje me parimin e subsidiaritetit, sipas të cilit, siç është pohuar në jurisprudencën kushtetuese, kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese është në radhë të parë funksion i gjykatave të zakonshme (*shih vendimet nr. 77, datë 05.11.2024; nr. 38, datë 02.12.2021; nr. 13, datë 09.03.2021; nr. 11, datë 16.04.2018 të Gjykatës Kushtetuese*). Po sipas Gjykatës, sistemi gjyqësor është një sistem korrigjues subsidiar, i cili nga mënyra sesi është ndërtuar dhe funksionon u përgjigjet të gjitha pretendimeve për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore (*shih vendimin nr. 1 datë 26.01.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Nga ana tjetër, e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë dhe funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 23, datë 04.04.2024; nr. 19, datë 07.07.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Në rastin konkret, Kolegji vëren se neni 47, pika 2, i ligjit nr. 10304/2010, sipas përmbajtjes së kohës, ka parashikuar se leja revokohet kur janë mbaruar rezervat gjeologjike dhe zotëruesi kërkon revokimin e saj (*shkronja "b"*) dhe kur, për shkaqe natyrore ose gjeologo-minerare, bëhet e papërshtatshme për vazhdimin e shfrytëzimit (*shkronja "c"*). Ndërsa, sipas nenit 48, procedura e revokimit të lejes fillon, si rregull, me raportin e propozimit të strukturës përgjegjëse ose me kërkesë të zotëruesit të saj, kur ky i fundit ka plotësuar të gjitha detyrimet e saj (*pika 1*), ndërsa revokimi në të gjitha rastet vendoset nga ministri (*pika 5*). Po sipas këtij

neni, ministri, në bazë të propozimit të strukturës përgjegjëse, njofton zotëruesin e lejes minerare, duke specifikuar qëllimin e tij për të hequr ose pezulluar lejen minerare dhe arsyen e një veprimi të tillë, ndërsa revokimi i lejes bëhet prej tij brenda një periudhe 30-ditore nga njoftimi i zotëruesit.

28. Në çështjen në shqyrtim, Kolegji vëren se procedura për revokimin e lejes ka filluar bazuar në raportin propozues të grupit të punës të MEI-it, i cili në datat 4-9 nëntor 2013 ka ushtruar kontroll për verifikimin në vend të problematikave të aktiviteteve minerare në rajonin krommbajtës Bulqizë, duke përfshirë aktivitetin minerar të koncesionarit dhe aktivitetet minerare të 38 subjekteve të tjera përreth lejes së tij. Në përfundim të verifikimeve, grupi i punës ka konkluduar se leja e shfrytëzimit e stoqeve dhe sterileve e kërkueses ndodhej me mbivendosje të pjesshme me koordinatat e lejes minerare të koncesionarit, çka kishte dëmtuar dhe rrezikonte shembjen e rrugës që lidhte pusin e thellë A1, vaskën e shllamit, linjën e koncentratit, godinat e rojeve, kampingun e ngritur për pusin 9 dhe sheshin e përpunimit të mineralit. Po sipas raportit, në datën 12.09.2013, pas shirave të vrullshëm, ishte evidentuar rrëshqitja dhe çarja e vaskës së shllamit, për shkak të aktivitetit të shoqërive sa më sipër, me pasojë dëmtimin e një numri banesash dhe rrugëve e kanalizimeve të qytetit të vjetër të Bulqizës. Në këtë situatë, me qëllim shmangien e mosrespektimit të detyrimeve të marra përsipër përmes marrëveshjes koncesionare, organi shtetëror duhej të merrte masa për revokimin e lejeve minerare të subjekteve që prej muajsh nuk kryenin aktivitet minerar, për shkak të përfundimit të shfrytëzimit të stoqeve dhe sterileve nën pacakën ku ndodheshin zyrat, impianti i seleksionimit dhe vaska e shllamit të koncesionarit, përfshirë edhe lejen nr. 1486/2010 në emër të kërkueses.

29. Pas komunikimit të përmbledhjes së raportit, me urdhrin nr. 159/2013 ministri i MEI-it, bazuar në nenin 47, pika 2, shkronjat “b” dhe “c”, të ligjit nr. 10304/2010, ka revokuar lejen e kërkueses, me arsyetimin e përfundimit të shfrytëzimit të rezervave. Në kërkesëpadinë drejtuar gjykatës së shkallës së parë kërkuesja ka pretenduar se, sipas raportit teknik të ekspertit privat, të vënë në dispozicion të gjykatës së bashku me kërkesëpadinë, rezervat minerare të kromit në zonën ku ajo ushtronte veprimtarinë e shfrytëzimit ishin mbi rezervën gjeologjike të llogaritur dhe kjo rezervë as ishte prekur, as kishte shteruar.

30. Në analizë të pretendimeve të kërkueses, gjykata e shkallës së parë ka vënë në dukje se në rastin e kërkueses nuk ishin zbatuar detyrimet e parashikuara në nenin 48 të ligjit nr. 10304/2010 për njoftimin e saj për qëllimin e revokimit të lejes. Pavarësisht këtij fakti, gjykata ka vlerësuar se në gjykim nuk ishin paraqitur prova të mjaftueshme që mund ta bindnin atë se nëse procedura e njoftimit të zotëruesit të lejes do të ishte respektuar, ministri i MEI-së, si

organi kompetent për nxjerrjen e aktit për revokim të lejes minerare, nuk do të kishte dalë me akt disponimi për revokim, pasi sipas gjetjeve të raportit të grupit të punës së MEI-it, ushtrimi i aktiviteteve paralele në të njëjtën sipërfaqe toke veprimi, por në nivele të ndryshme, kishte dëmtuar dhe paraqiste rrezik për shembje rruge e dëmtonte veprimtarinë e koncesionarit. Po kështu, shfrytëzimi i stoqeve sterile në zonën e mbivendosur kishte përfunduar. Në analizë të urdhrit të ministrit, gjykata ka vënë në dukje se ai u referohej shkronjave “b” dhe “c” të nenit 47 të ligjit nr. 10304/2010, si shkaqe për revokimin e lejes. Ndërsa situata e parashikuar në shkronjën “b”, e cila kërkonte vullnetin e zotëruesit të lejes, nuk plotësohej në rastin në fjalë, gjykata ka vlerësuar se papërshtatshmëria e vazhdimit të shfrytëzimit, sipas shkronjës “c”, nuk e kërkonte një gjë të tillë. Në këto kushte, edhe pse në përmbajtje urdhri i referohej përfundimit të shfrytëzimit të rezervave, paligjshmëria potenciale e këtij shkak nuk lidhej me tejkalimin e kompetencave të ministrit, por me vlerësimin e gabuar të ligjit material, pra nuk përbënte shkak për pavlefshmëri absolute. Po ashtu, gjykata ka vënë në dukje se neni 48, pika 5, i ligjit nr. 10304/2010 parashikonte shprehimisht se revokimi, në të gjitha rastet, vendosej nga ministri, në bazë të raportit të strukturës përgjegjëse, pra ministri i MEI-it kishte autoritetin për të nxjerrë aktin revokues ndaj një lejeje minerare, ndaj në këtë këndvështrim nuk plotësohej as situata e parashikuar në nenin 116/b të KPA-së. Për rrjedhojë, padia duhej rrëzuar si e pabazuar në ligj dhe në prova (*shih faqet 12-15 të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë*).

31. Vendimi i gjykatës së shkallës së parë është gjetur i drejtë nga gjykata e apelit, e cila, pas riçeljes së hetimit gjyqësor, administrimit të provave të paraqitura në gjykim nga kërkuesja, përfshirë studimin e studios “Technoprojekt” për përcaktimin e rrezikshmërisë së vaskave të shllamit nga influenza e shfrytëzimit të përpunimit të stokut të sterileve nga leja minerare 1486/2010 në zonën veriore dhe të kufirit të lejes minerare, si dhe pyetjes në cilësinë e dëshmitarit të inxhinierit që, në cilësinë e ekspertit që kishte përgatitur studimin, me të njëjtin arsyetim, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë (*shih faqet 6 dhe 8 të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit*). Ndërsa, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se shkaqet e ngritura në rekurs nuk ishin nga ato të parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative”.

32. Në këndvështrim të sa më sipër, Kolegji vë në dukje se pretendimet për cenimin e së drejtës për t’u dëgjuar në procesin administrativ janë parashtruar nga kërkuesja përgjatë procesit gjyqësor. Gjykimi i çështjes në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është zhvilluar në prani të përfaqësuesit ligjor të saj, i cili ka parashtruar pretendimet e kërkueses, përfshirë ato për cenimin e së drejtës për t’u dëgjuar në procesin administrativ. Po

kështu, gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë janë vënë në lëvizje përmes ankimit dhe rekursit të kërkuësës, ku janë parashtruar edhe argumentet për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar. Pretendimet e saj janë analizuar dhe vlerësuar nga këto gjykata përkundrejt parashikimeve të ligjit material e procedural, duke marrë përgjigje të arsyetuara në vendimmarrjet gjyqësore. Në këtë situatë, Kolegji vëren se, në përputhje me parimin e subsidiaritetit, në vlerësimin e veprimeve dhe vendimmarrjes së organit administrativ gjykatat e zakonshme kanë vepruar në respektim të së drejtës së kërkuësës për t'u dëgjuar. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se pretendimet e saj për cenimin e kësaj të drejte janë haptazi të pabazuara.

33. Po kështu, Kolegji vë në dukje se në vendimmarrjet e tyre gjykatat e zakonshme kanë marrë në analizë edhe pretendimet e kërkuësës për shkaqet e parashtruara në urdhrin e ministrit. Duke mbajtur parasysh edhe vlerësimet e akteve të ekspertit të paraqitura nga kërkuësja në gjykim, gjykatat kanë argumentuar në qëndrimin e tyre se, pavarësisht se në urdhër ishte arsyetuar vetëm për shkakun i përfundimit të shfrytëzimit të rezervave, i parashikuar nga neni 47, pika 2, shkronja "b", i ligjit nr. 10304/2010, në përmbajtje ai i referohej edhe shkakut të papërshtatshmërisë së vijueshmërisë së shfrytëzimit të zonës, të parashikuar nga shkronja "c" e kësaj dispozite, si rrjedhojë e gjetjeve të grupit të ekspertëve të MEI-it. Në analizë të vendimeve gjyqësore dhe pretendimeve të parashtruara në gjykim nuk rezulton që shkakun i papërshtatshmërisë së vijueshmërisë së zbatimit të lejes të jetë vënë në diskutim nga kërkuësja në gjykatat e zakonshme. Po kështu, në kundërshtim nga sa pretendohet, vendimet e gjykatave janë mbështetur në një analizë tërësore të pretendimeve të parashtruara prej saj përkundrejt parashikimeve të legjislacionit të zbatueshëm, duke mbajtur qëndrim të arsyetuar për konkluzionet e arritura në vendimmarrje. Në këtë situatë, si dhe duke pasur parasysh se përcaktimet lidhur me shkakun e dytë të revokimit të lejes kanë të bëjnë me vlerësimin e fakteve dhe provave, çka nuk i përket juridiksionit kushtetues, Kolegji vlerëson se pretendimet e kërkuësës për cenimin e së drejtës për gjykim të drejtë, si rrjedhojë e mosmarrjes parasysh nga gjykatat të pretendimeve të saj për pavlefshmërinë absolute të urdhrin të ministrit, janë haptazi të pabazuara.

34. Për sa më sipër, Kolegji çmon se pretendimet e kërkuësës për cenimin e së drejtës për gjykim të drejtë të lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar dhe standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor janë haptazi të pabazuara.

35. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.